



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:043699  
Datë: 21.10.2024  
Numri i dokumentit: 06288888

KF.nr.546/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “NLB Bank” Sh.A, me numër unik identifikues 810486250, dhe me seli në Rr. Ukshin Hoti nr.124, Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti kërkesë për kompensim debi kredi, vlerë kontesti 291,366.68€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me 07.10.2024 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të paditësit Ardian Kadrija, Ruzhdi Zenelaj dhe Visar Kabashi, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Agron Ndrecaj, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “NLB Bank” Sh.A., me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi nr.637/2021 i datës 31.01.2022 i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, “NLB Bank” Sh.A t’ia kthej mjete e paguara më tepër në emër të tatimeve sipas deklaratës vjetore CD të vitit 2015, në vlerë të përgjithshme prej 291,366.68€ (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 03.03.2022, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.637/2021 të datës 31.01.2022 për arsye se, siç potencohet në padi, dokumenti i nxjerr ka gabime faktike, pa marr parasysh se gabimi është paraqitur apo jo në dokument dhe se dokumenti ligjor ka gabime ligjore, pa marrë parasysh se gabimi është paraqitur apo jo në dokument. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë duke e konsideruar si të drejtë dhe të argumentuar. Përgjigjen në padi e konsideron si të pabazuar në asnjë fakt apo bazë ligjore sepse e njëjta është vetëm përsëritje e vendimit të atakuar. Tutje deklaroi se nuk ka asnjë kontest se mbi pagesa prej 291,366.68€ ka ekzistuar në gjendjen e përgjithshme të paditësit e cila nxjerrët nga sistemi i IP së palës së paditur. Duke qenë se neni 30 i ligjit 03/L-222 ka qëndruar në heshtje në lidhje me çka ndodh pas gjashtë viteve konstaton se kjo mbi pagesë është pronë e paditësit. Thekson se e para që ka rëndësi në këtë pikë është se paditësi nuk e ka tejkaluar afatin gjashtë vjeçar të kërkesës për kthimin e mjeteve sepse këto mjete me 15.12.2016 janë paguar përmes sistemit të bartjes (forma debi kredi) në periudhën e tatimit për korporata të viti 2015. Kjo pagesë përmes sistemit të bartjes nuk ka dyshim se konsiderohet moment i ri i pagesës e cila është aprovuar edhe nga vet pala e paditur në kohën e kërkesës. Fakti që kërkesa e re për kryerjen e këtyre detyrimeve kundrejt borxheve të atij momenti është bërë me dt. 13.10.2021, nënkupton se kërkesa ka qenë valide dhe brenda afatit gjashtë vjeçar të paraparë me nenin 30 të ligjit, si kërkesë periodike. Edhe në situatën hipotetike sikur të ishte kaluar ky afat përderisa legjislacioni ka qëndruar i heshtur se çka ndodh nëse kalohet afati kjo nënkupton se paratë e paguara tepër të paditësit gjithmonë mbesin pronë e tij dhe janë të regjistruara në bilancin e gjendjes si pronë e personit juridik në përputhje me standardet kosovare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit. Tutje i referohet Kushtetutës së Kosovës nenit 7, nenit 24 dhe nenit 46, sipas të cilës i jepet e drejta në pronë secilit si e pa kontestueshme dhe i jepet mundësia që prona të eksproprijohet mirëpo në këto raste personit të cilit i eksproprijohet prona duhet të kompensohet njëtrajtshëmrisht. Kërkesëpadinë e ka precizuar me kërkesë që gjykata të anuloi vendimin e Departamentit të Ankesave me nr. protokollin 637/21 të datës 31.01.2022, të urdhëroj palën e paditur që të rimbursoj mjetet prej 291,366.68€ dhe të kompensojë kamatën ligjore prej 8% në interes vjetor.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 17.07.2024, i kundërshton pretendimet e paditësit në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka mbështetje ligjore dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshmen në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor deklaron se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi të datës 17.07.2024 ku në mënyrë të detajuar janë dhënë shpjegime për arsyet e refuzimit të kërkesës së paditësit, ku edhe si provë është bashkangjitur në këtë përgjigje në padi analiza ligjore e datës 28.04.2014 e cila është lëshuar nga zyra ligjore e ATK-së ku në mënyrë të detajuar është folur për afatet kohore të drejtës së T/P në tërësi dhe ATK këtë mënyrë unike të interpretimit të dispozitës ligjore e aplikon ndaj të gjithë T/P pa përjashtim. Andaj nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se ATK nuk e ka paraparë një gjë të tillë pasi që tani kemi edhe precedentë. Po ashtu nuk qëndron pretendimi i përfaqësuesit të palës paditëse se kërkesa është bërë brenda fatit ligjor, kërkesa është parashtruar me dt 13.10.2021, pasi që bazuar në dispozitën e nenit 41 par 11 afati ka përfunduar me datën 15.01.2016, pasi që është dashur të bëhen deklaratimet dhe pagesat për këstet tre mujore, për pagesën e paguar të tatimit me datat TM1/2015 deri me 15.04.2015, TM2/2015 deri me 15.07.2015, TM3/2015 deri me 15.10.2015 dhe TM4/2015 deri me 15.01.2016, por paditësi nuk e ka bërë këtë dhe nuk ka respektuar këtë afat ligjor pasi që paditësi nuk ka bërë pagesat e rregullta për këste. Pra ka kaluar afati gjashtë vjeçar i paditësit referuar interpretimit të lartcekura nga zyra ligjore e ATK për të kërkuar kompensimin e debive dhe kredive. Gjithashtu edhe zyra ligjore në interpretimin e lartcekur ka dhënë interpretimit të zbatimit të nenit 30 të ligjit 03/L-222 fakt i cili rrëzon pretendimin e paditësit të lartcekur në këtë seancë dhe ky interpretim është lëshuar nga zyra ligjore. Kërkon nga ana e gjykatës që me vëmendje t'i trajtojë arsyetimet në këtë objekt kontesti pasi që diçka që është e rregulluar me legjislacionin e veçantë dhe në mënyrë shumë të qartë ka interpretimit të tillë si të veprohet ndaj të gjithë T/P pasi në këtë mënyrë ATK e përfillë këtë dispozitë ligjore që një dekadë dhe të mos krijojë precedentë që do të jenë në dëm pasi që çdo e drejtë e cila është paraparë sipas legjislacionit tatimor e ka edhe një afat të parashkrimit të asaj të drejte. Se sikur të ishte ndryshe shembull tani një T/P të kërkojë borxhin e vitit 2005 atëherë do krijohej një precedent i keq në dëm të buxhetit të shtetit, me këtë edhe ATK edhe në përgjigje në padi nuk e ka kontestuar shumën e kërkuar nga T/P mirëpo arsyeja e refuzimit me vendimin i cili është objekt kontesti skadimi i afatit kohor të cilën e ka paraparë legjislacioni tatimor i cili është në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 07.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Përgjigje në padi e datës 17.07.2024, Forma për vizita përmbushëse datë 22.11.2021, Detajet e vlerësimit datë 17.11.2021, Transaksionet llogarisë tatimor datë 21.01.2022, Të gjitha transaksionet llogarisë tatimore, Deklarata vjetor e tatimit mbi korporata për periudhën 12.2015, Kërkesë për kompensimin e debi kredive datë 13.10.2021, Email datë 13.10.2021, Përgjigje e ATK e datë 22.11.2021, Opinion ligjor i zyrës ligjore i ATK datë 28.04.2014, Ankesë 22.11.2021, Vendim nr.637/2021 datë 31.01.2022, Kërkesë për kompensim e debi kredive të T/P datë 13.12.2016 dhe e datës 30.03.2018 dhe 24.12.2018, Gjendja e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera datë 04.10.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi me datën 13.10.2021 ka paraqitur pranë të paditurës kërkesën për debi –kredi nga gjendja e mbi pagesës së CD-së e vitit 2015 në shumë prej 291,366.68€. Jo kontestues mbetet edhe fakti se paditësi ka pranuar përgjigje nga e paditura me datë 24.11.2021 se nuk është aprovuar kërkesa e datës 13.10.2021. Jo kontestues mbetet edhe fakti se paditësi ndaj të njëjtës, ka parashtruar ankesë në Departamenti e Ankesave të ATK-së, i cili përmes vendimit nr.637/2021 të datës 31.01.2022 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e ka refuzuar ankesën e paditësit, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 03.03.2022, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor këtu

paditësit, me arsyetim se Divizioni i Ankesave këtë vendosje-vlerësimin e ka mbështet në nenin 30 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 30 dhe nenin 41, paragrafi 11 të UA 15/25010, dispozita këto që parashohim rregullimin e kompensimit të debi-kredive, si dhe përgjigjen nga zyra ligjore nr. DL&A nr.04/2014. Duke u bazuar në këto dispozita ligjore e paditura ka konstatuar se tatimpaguesit nuk i takon e drejta për kompensim debi kredi sipas kërkesës së bërë për arsye se e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor gjashtë vjeçar të paraparë me dispozitën e nenit 30 paragrafi 3 të Ligjit 03/L-222. E paditura gjithashtu është bazuar edhe në nenin 41 paragrafi 11 të UA 15/2010, dhe konstaton se në bazë të këtij paragrafi paditësi ka qenë i obliguar t'i deklaroj pagesat për këstet tremujore, por nuk ka bërë pagesa të rregullta, mirëpo të njëjtat i ka bërë përmes kompensimeve debi-kredi.

Këto konstatime të paditurës në vendimin kontestues, për gjykatën janë në tërësi të paargumentuara dhe pa mbështetje ligjore dhe si të tilla nuk konsiderohen të drejta për arsyet si në vijim:

Paditësi me datën 13.10.2021 ka kërkuar nga e paditura kompensimin e debi kredive nga deklarata CD 2015 për mbulimin e tatimeve të vitit 2021. Kërkesa të tilla për kompensim, paditësi ka bërë edhe në periudhat tjerat tatimore të paraqitura si në shkresat e lëndës, e të cilat janë realizuar nga e paditura pa kundërshtime. Nga gjendja e deklarimeve në ATK e tatimpaguesi – këtu paditësit, gjykata konsideron se i njëjti balancën kreditore pozitive e ka vetëm për CD e vitit 2015, ndërsa deklaratat tjera CD për vitin 2014, 2013, janë zero. Rrjedhimisht edhe pretendimi i të paditurës se paditësi ka bërë kërkesë për rimbursim jashtë afatit ligjor është i pabazuar, për faktin se paditësi kërkesën e ka bërë me datën 13.10.2021 për CD e vitit 2015 e cila kërkesë është brenda afatit ligjor gjashtë vjeçar ashtu siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 30 “*Kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloj tatimi mund të dorëzohet brenda 6 vitesh nga data kur është paguar tatimi. procedura për aplikim të rimbursimit të tatimit do të rregullohet me akt nënligjor*”. Ndërsa pretendimi i të paditurës se mbi pagesa e CD të vitit 2015 është rezultat i mbi pagesave të vitit 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, është në tërësi i pabazuar, pasi që paditësi të drejtën për transferim për këto vite e ka shfrytëzuar paraprakisht, ku në shkresat e lëndës nga vet deklaratat e të paditurës si dhe në vendimin kontestues është deklaruar se paditësi ka bërë kërkesë për kompensimin debi kredit me datën 30.03.2018 dhe 24.12.2018, nga ku shumat e CD-së nga vitet paraprake janë transferuar në vitin 2015. Prandaj paditësi e ka shfrytëzuar të drejtën për kompensim të mjeteve nga

CD 2010, CD 2011, CD 2012, CD 2013 dhe CD 2014, në momentin kur të njëjtat janë transferuar në CD 2015 pikërisht me datat 30.03.2018 dhe 24.12.2018.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin tjetër në vendimin kontestues, i mbështetur në paragrafin 11 të nenit 41 të UA 15/2010 e cila parasheh: *“Kërkesa për rimbursim mund të dorëzohet në çdo kohë pas afatit për dorëzimin e deklaratës së aplikueshme deri në 6 vjet nga data kur është paguar tatimi. Për qëllime të përcaktimit të satës së pagesës së tatimit, pagesa paradhënie e tatimit në të ardhurat të Korporatave (TAK) apo Tatim në të Ardhura Personale (TAP), do të konsiderohet të jetë paguar në datën kur deklaratat e tilla janë detyruese për të dorëzuar në ATK”*. E paditura ka konstatuar se tatimpaguesi nuk i ka deklaruar Këstet Mujore për Pagesën e Paguar të Tatimit me datat e parapara për pagesë ashtu siç janë cekur në vendimin kontestues, dhe nuk i ka bërë pagesat e rregullta me këste, por të njëjtat i ka bërë përmes kompensimeve debi kredi. Këtë konstatim në vendimin kontestues gjykata e konsideron si të pabazuar dhe kundërthënës me vetveten për fakti se nga njëra anë thekson se tatimpaguesi nuk i ka bërë pagesat e rregullta dhe nga ana tjetër deklaron se të njëjtat i ka bërë përmes kompensimeve. E paditura me asnjë provë nuk e ka dëshmuar faktin se paditësi ka deklarata të padeklaruara në sistemin e deklarimeve në ATK dhe se i njëjti ka ndonjë borxh të papaguar ndaj të paditurës, për me tepër vet e paditura nuk e konteston faktin se shuma në vlerë prej 291,366.68€ është mbi pagesë e tatimit nga ana e paditësit.

Gjykata ka shqyrtuar edhe interpretimin e zyrës ligjore të të paditurës të datës 28.04.2014, dhe konsideron se i njëjti nuk është i lëshuar për rastin konkret, mirëpo në të sqarohen vetëm dispozitat ligjore që përcaktojnë afatin gjashtë vjeçar për kompensimin e debi kredive. Prandaj gjykata të njëjtin nuk mund ta konsideroj si provë për të vendosur ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi gjykata ka sqaruar mjaftueshëm dispozitat ligjore që janë të zbatueshme për rastin konkret.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamje ligjore, për t'ia kthyer mjetet e paguar më tepër, në shumën prej 291,366.68€ në emër të mbi pagesës tatimore të CD-2015. Prandaj Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ e miratoj

kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësit t'ia kthej mjetet e paguara më tepër në shumën e përgjithshme prej 291,366.68 (dyqindën e njëzet e pesë mijë e pesëqind e katërmbëdhjetë euro e tredhjet e shtatë cent), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë 01.03.2022 e deri në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruaragjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Sa i përket përcaktimit të vlerës së kontestit, gjykata të njëjtën e ka nxjerr nga deklaratat tatimore të paditësit të nxjerra nga e paditura ATK, dhe e njëjta nuk ka qenë kontestuese as nga e paditura. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se *“ATK në përgjigje në padi nuk e ka kontestuar shumën e kërkuar”*. Ndërsa sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës, është marrë data e data e nxjerrjes e këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitë nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.546/22 datë 07.10.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.